



Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale – potencial i pashfrytëzuar në luftimin e korrupsionit në prokurim publik

Hyrje

Institucionet publike si dhe ndërmarrjet në pronësi publike duhet të prokurojnë mallra, shërbime dhe punë për të përmbushur përgjegjësitë dhe detyrat e tyre. Vëllimi total i prokurimeve publike gjatë vitit 2023 në Kosovë ishte 810,438,403.40 euro apo 8.23% i Bruto Produktit Vendor (BPV)¹. Prokurimi publik është i prirur ndaj parregullësive dhe i cenueshëm ndaj korrupsionit², ku përveç volumit të lartë të kontratave të nënshkruara, mbi 10,183 gjatë vitit 2023³, dhe interesave të mëdha financiare, rreziqet e korrupsionit rriten edhe për shkak të mungesës së një sistemi të drejtësisë mjaftueshëm të fuqishëm dhe efikas për të adresuar shkeljet në këtë fushë.

Kodi Penal i Kosovës ka dispozitë të veçantë për keqpërdorimin dhe mashtrimin në prokurim publik⁴, ndërkohë Kodi i Procedurës Penale i konsideron këto vepra si krime të rënda⁵. Kosova në vitin 2011 ka miratuar edhe Ligjin për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale⁶, me të cilin rregullohet përgjegjësia e personave juridik për vepra penale dhe sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personave juridik. Ky ligj parasheh përgjegjësi penale për personat juridik për veprat penale të kryera nga individë që veprojnë në emër të tij, me qëllimin që ndërmarrja e veprimeve të paligjshme për realizimin e dobive të këtyre pasojave për vetë entitetet juridike dhe jo vetëm për individët e përfshirë. Ky ligj parasheh gjyba të mëdha për veprat penale të personave juridik, gjyba të cilat nuk mund të

1 Raporti Vjetor 2023. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Gjendet: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raporti%20Vjetor%202023.pdf>

2 Kosovo Report 2024. European Commission. Gjendet në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf

3 Po aty.

4 Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Neni 415. Gjendet: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6A2D4377-6AE1-4530-909F-3FB2680CD1EC.pdf>

5 Kodi nr.08/L-032 i Procedurës Penale. Neni 22, 1.2.75. Gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61759>

6 Ligji nr.04/L-03- Për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale. Gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2766>

jenë më të vogla se 1,000 euro dhe jo më të larta se 100,000 euro. Përveç gjobave, dispozitat e këtij ligji parashohin pushimin e personit juridik, dënimet me kusht, masat e sigurisë të cilat përfshijnë ndalimin e kryerjes së veprimtarive për punë të caktuara dhe konfiskimin e dobisë pasurore.

Megjithatë, ky ligj nuk po gjen zbatim në Kosovë, sidomos në rastet që lidhen me keqpërdorimet në fushën e prokurimit publik. Gjykatat vazhdojnë të shqiptojnë dënime minimale ndaj personave fizik në këto raste pronarëve të kompanive, duke injoruar përgjegjësinë dhe sanksionet ndaj personave juridik, pra ndaj vetë kompanive.

Në këtë analizë të shkurtër, përmes tri rasteve ilustron praktika e amnistisë ndaj personave juridik të cilët kanë përfituar kontrata të mëdha publike përmes mashtrimeve dhe falsifikimeve, ndaj të cilave nuk janë shqiptuar sanksione të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridik.

Rasti 1

Dënimi vetëm për pronarin e kompanisë

Në vitin 2022, Gjykata Themelore në Gjiilan, shpalli aktgjykim dënues për J.M⁷, drejtor i kompanisë “Tribune Sh.P.K.”, i cili gjatë vitit 2021, gjatë ofertimit për kontratën “Renovimi dhe meremetimi i objekteve spitalore dhe rregullimi i ngrohjes qendrore” në Spitalin e Përgjithshëm të Gjiilanit, kishte paraqitur dokumentacion të rremë, përmes të cilit kompania “Tribune Sh.P.K”, kishte fituar kontratë në vlerë 47,058.03 euro.

Duke u bazuar vetëm në dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale por duke mos aplikuar Ligjin për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale, gjykata dënoi pronarin J.M, si person fizik me gjobë prej 4,780 euro, si dhe dënim plotësues për ndalimin e pjesëmarrjes në procedura të prokurimit publik për një (1) vit, por nuk shqiptoi asnjë dënim për subjektin juridik “Tribune Sh.P.K”, që kishte realizuar dobi financiare nga konsumimi i veprës penale.

⁷ Gjykata Themelore në Gjiilan. PKR. Nr.208/2021. Gjendet në: [0191-RulingOnDetention](#)

Rasti 2

Dëmi afër 2 milionë euro, dënimi 20 mijë euro

Në vitin 2022, Gjykata Themelore në Gjiilan, shpalli aktgjykim dënues⁸ për I.H, themelues dhe drejtor i biznesit “Globi – MI”, i cili gjatë viteve 2018 – 2020, kishte dorëzuar dokumente të falsifikuara në pesë (5) procedura të tenderimit, ku në tri (3) prej tyre ishte shpallur fitues duke lidhur kontrata me Komunën e Gjiilanit dhe Komunën e Kamenicës. Veprimet e I.H, në emër të kompanisë “Globi – MI”, i eliminuan konkurrentët e tjerë, duke u sjell dobi pasurore kompanisë së tij në vlerë 1,919,644.24 euro, ndërkohë gjykata, duke u bazuar vetëm në Kodin Penal, e dënoi I.H me 20,000.00 euro dhe një (1) vit dënim, i cili nuk do të ekzekutohej në qoftë se i pandehuri në afat verifikues prej dy (2) viteve, nuk do të kryente vepër tjetër penale. Gjykata po ashtu ia ndaloi pronarit I.H pjesëmarrjen në prokurim publik, ndonëse i njëjti kishte marrë pjesë vetëm si person juridik në prokurim publik.

Ndalimi i pjesëmarrjes në prokurim publik ndaj pronarit të kompanisë nuk ka efekt sanksionues në praktikë ndaj kompanisë e cila kishte përfituar nga vepra penale, siç e ilustron ky rast, pasi I.H nuk kishte marrë pjesë asnjëherë si person fizik në kontrata publike. Në ndërkohë, kompania “Globi – MI”, ndaj të cilës nuk u shqiptua asnjë ndalesë e pjesëmarrjes në prokurim publik, vetëm pesë muaj më vonë arriti të fitojë një tjetër kontratë publike me Komunën e Gjiilanit në vlerë 77,550.00 euro⁹.

Rasti 3

Dënime të shumta, kompania vazhdon të fitojë kontrata publike

Në vitin 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda¹⁰, nxori aktgjykim dënues për T.S, i cili gjatë vitit 2020, si pronar i kompanisë “NTB ING Sh.P.K”, kishte prezantuar dokumente të falsifikuara në tenderin për renovimin e objektit të Prokurorisë Speciale të Kosovës, tender në të cilin ishte shpërblyer me kontratë në vlerë 811,372.13 euro. Me këtë aktgjykim, gjykata dënoi vetëm pronarin e kompanisë – gjobë në shumën 2,000 euro dhe burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, duke ja ndaluar pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik për një kohëzgjatje prej një (1) viti, por nuk shqiptoi asnjë lloj sanksioni ndaj kompanisë “NTB ING Sh.P.K”.

Kjo kompani, pronari i së cilës ishte dënuar edhe në vitin 2021 për falsifikim të dokumenteve për një kontratë publike në vlerë të parashikuar të kontratës 1,000,000.00 euro, vazhdoi të fitojë kontrata publike, duke u shpërblyer me kontratë në vlerë 386,096.29 euro për renovimin e kulmit të objektit të Komunës së Prishtinës.

⁸ Gjykata Themelore në Gjiilan. PKR.nr79/2022. Gjendet në: https://www.gjuqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/GJ_PKR_2022-276619_SQ.pdf

⁹ Kontrata me nr.651-22-11891-5-2-1/C417 me titull “Terenet sportive në shkollat e Komunës së Gjiilanit”.

¹⁰ Gjykata e Apelit të Kosovës, përmes të cilës vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë. PAKR.nr.602/2022. Gjendet në: [0191-RulingOnDetention](#)

PËRFUNDIME:

Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale nuk po gjen zbatim adekuat në Kosovë, me personat juridik të cilët nuk mbajnë përgjegjësi penale dhe ndaj tyre nuk shqiptohen sanksione penale nga gjykatat për veprat penale të cilat realizohen me qëllim të përfitimit material.

Në mungesë të zbatimit të këtij ligji, kemi një shpërputhje të madhe mes fitimeve të paligjshme të realizuara nga kompanitë e papërgjegjshme në kontrata publike, dhe sanksioneve të shqiptuara ndaj tyre, siç e ilustron rasti i kompanisë “Globi – MI”, që përmes falsifikimit kishte përfituar kontrata publike në vlerë prej 1,919,644.24 euro, ndërkohë gjoba ndaj pronarit të kompanisë ishte vetëm 20,000.00 apo 1% e shumës së fituar përmes konsumimit të veprës penale.

Dënimet minimale vetëm për individët e përfshirë në vepra penale dhe diskualifikimet për pronarët e kompanive nga pjesëmarrja në prokurim publik, krijon një ambient ku këto kompani jo vetëm që shmangin gjambat dhe pezullimet e paraparë me këtë ligj, por ato vazhdojnë të marrin kontrata publike duke dëmtuar konkurrencën e drejtë dhe integritetin e procesit të prokurimit publik.

REKOMANDIME:

- Organet e drejtësisë, duke përfshirë Prokurorinë dhe Gjykatat të aplikojnë dispozitat e Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale, duke përfshirë gjambat, ndalimet dhe konfiskimet e dobive pasurore të kompanive, të cilat realizojnë dobi ose shkaktojnë dëm nga kryerja e veprave penale të parapara në Kodin Penal.
- Diskualifikimet nga pjesëmarrja në prokurim publik të shqiptohen ndaj personave juridik, pra ndaj kompanive pasi janë kompanitë ato që fitojnë kontrata publike si pjesëmarrëse në procedurat e tenderimit dhe jo pronarët si persona fizik.
- Të këtë trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët për të adresuar më mirë veprat penale të personave juridik dhe për të siguruar që sanksionet të jenë proporcionale dhe efektive.
- Të këtë një fushatë të rritjes së ndërgjegjësimit publik për informimin e qytetarëve dhe personave juridik për rëndësinë e përgjegjësisë penale të personave juridik dhe pasojat e korrupsionit.